

Shenjtori i ditës: Apostujt Filemoni e Apfia, Arkipi, Onesimi nga të 70-t - Dëshmor Mihaili i Tverit



E diel, 22 nëntor 2020 – Shenjtori i ditës

JEMI NË KRESHMËN E KRISHTLINDJES

(15 NËNTOR – 25 DHJETOR)

Apostujt Filemoni e Apfia, Arkipi, Onesimi nga të 70-t. Klimi i Ohrit. Dëshmore Cecilia. Dëshmor Mihaili i Tverit.

– Apostujt Filemoni e Apfia, Arkipi, Onesimi nga të 70-t –

Shën Filemoni vinte nga një familje e pasur dhe fisnike e Kolosit në Frigji dhe u bë i krishterë, kur dëgjoi predikimin e apostullit të shenjtë Pavli, bashkë me gruan e tij, Apfian dhe të birin, Arkipin. Plot besim dhe me dashuri të flaktë për ta mbështetur dhe për të ndihmuar gjithë vëllezërit më Krishtin, Filemoni e mblidhte komunitetin në shtëpinë e vet, për të kremtuar Misteret e shenjta dhe për lutje: pasi në atë kohë, nuk kishte filluar ndërtimi i kishave.

U gjykua i denjë për besimin e apostullit, u hirotonis episkop i Gazës në Palestinë dhe zhduku nga ky qytet padijen me dritën e predikimit. Sapo u kthye në Kolos, e vazhdoi veprën e tij misionare, me gjithë kundërshtimin e tërbuar të paganëve. Një ditë, kur këta festonin për Artemisën, apostujt e shenjtë adhuronin të vetmin Mbret dhe Zot të të gjithave. Paganët e morën vesh këtë dhe u vërsulën për t'i kapur dhe i nxorën para qeveritarit Andronikli. Por, meqë Arkipi refuzoi t'u sakrifikonte idhujve, u rrah i pari, u shpua me gjilpëra nga disa fëmijë mizorë dhe mbaroi i vrarë me gurë. Edhe shën Filemoni dhe Apfia vuajtën shumë tortura dhe morën kurorën e martirit. Shën Onesimi, skllavi i tyre, mbijetoi dhe përmbushi më vonë shumë nga betejat e fundit të atletëve të Krishtit.



* * * * *

- Dëshmor Mihaili i Tverit -

Lindi në Tver më 1272 dhe ishte i biri i princit Iaroslav, vëllai i shën Aleksandër Nevskit. U edukua me virtytet e krishtera nga nëna e tij, e cila më vonë u bë murgeshë me emrin Ksenia. Meqë kishte jetuar që i vogël si murgjit, dëshironte të bëhej i tillë ose të martirizohej. Më 1285 u bë princ pas vëllait të madh. U martua me princeshën Ana Dimitrievna të Rostovit, më 1294 dhe pati katër djem e katër vajza.

Më 1304, u thirr që të bëhej princi i madh i Vladimirit, kryeqytet i Rusisë gjatë pushtimit mongol dhe fron i mitropolitit të Kievit. Por u privua nga kurora për shkak të intrigave politike të të afërmit të tij, princit të Moskës Georgi Danieloviç. Këshilltarët e nxitën të luftonte kundër tij, por Mihaili refuzoi dhe preferoi më mirë të linte pushtetin, sesa të derdhej gjaku i popullit. Por, kur princi i Moskës kërkoi të merrte me luftë Tverin, atëherë Mihaili u nis për luftë kundër kushëritit të tij. Fitoi, por e fali princin ambicioz.

Mes shumë robërve që zuri ishte edhe princesha Agathi, gruaja e Georgit. Ajo vdiq aksidentalisht dhe kjo ndezi tërbimin e Georgit, i cili nxiti kundër vëllanë e Agathisë, kreun e tartarëve. Kërkuan që Mihaili të shkonte për t'u gjykuar në oborin Hordhisë së Artë të tartarëve. Të afërmit e princit, duke qenë të sigurt për një fund të keq, i kërkuan shenjtit të fshihej, por ai, pas një bisede me atin e tij shpirtëror, pranoi të shkonte atje dhe të vdiste, që të kursehej populli i tij.

Tartarët e burgosën duke i vënë në qafë një zgjedhë të rëndë druri, e cila i bllokonte krahët, por megjithatë i kaloi ditët në lutje dhe psalme. Duke u gdhirë 22 nëntori i vitit 1318, atij iu zbulua vrasja e ardhshme. U kungua, hapi psaltirin dhe lexoi fjalët që profeti thotë në lidhje me vuajtjen e Krishtit: "Zemra ime është e tronditur brenda meje, dhe ankthet e vdekjes ranë mbi mua" (Ps. 54.5). Por ai shton: "Hidh mbi Zotin barrën tënde dhe ai do të të mbajë, nuk do të lejojë kurrë që i drejti të lëkundet" (Ps. 54.22).

I mbushur me kurajë dhe shpresë, priti me qetësi Georgin dhe njerëzit e tij, të cilët u sulën mbi të si bisha dhe e vranë me shpatë, pasi e kishin torturuar brutalisht.

Kur e kthyen në Moskë, lipsani i shenjtorit bëri shumë mrekulli dhe më 6 shtator

1320 u transferua solemnisht në Tver. Më 1549, shën Mihaili u shfaq si një kalorës për t'u dhënë zemër banorëve të qytetit të rrethuar nga lituanët dhe polakët.

SHĒN

MIKAILI
I TVERIT



— facebook.com/koash1991